REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 1874/1 prot. Tiranë, më 26. 10. 2026

V E N D I M

Nr. 278, datë 26. 10. 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 263, datë 13.10.2026, e S. C. kundër Bashkisë Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *"aftësisë së kufizuar*[1] *"*.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës së depozituar më parë nr. 223, datë 08.09.2026, subjekti ankues, ka parashtruar se: *"Që nga viti 2018 e deri më sot, trajtohem çdo vit me programin "Subvencionimi i qirasë" (Bonus Qiraje), së fundmi miratuar me Vendimin nr. 29, datë 30.03.2026 të Këshillit Bashkiak Tiranë. Sa herë që jam interesuar dhe kam kërkuar të aplikoj për "Banesë Sociale me Qira", përgjigja verbale nga punonjësit e Njësisë Administrative ka qenë: "Në mungesë të banesave sociale, ju ofrojmë bonusin e qirasë".*

Veç të tjerash, në ankesën nr. 263, datë 13.10.2026, ankuesi parashtron se: *"...1. Aplikimi në Formularët Zyrtarë të Njësisë Administrative Nr. 7: Që prej vitit 2018, sa herë kam aplikuar pranë Njësisë Administrative Nr. 7, formulari zyrtar i aplikimit përmban shprehimisht klauzolën ku thuhet: "Në mungesë të banesave sociale me qira dhe në mungesë të banesave me kosto të ulët, njësia e vetëqeverisjes vendore ofron subvencionimin e qirasë në tregun e lirë...". Kjo do të thotë*

[1] Referuar Vendimit nr. 4564, datë 18.10.2022 të KMCAP Niveli i Parë Paraplegji-Tetraplegji.

se aplikimi për "Bonus Qira", është i lidhur drejtpërdrejtë nga vetë bashkia me mungesën e banesave sociale.

2. Pamundësia objektive për aplikim të veçuar: Gjatë këtyre 8 viteve, pranë Njësisë Administrative Nr. 7 nuk është hapur asnjëherë thirrje e veçantë ose procedurë më vete për aplikim për Banesa Sociale me Qira. Përgjigja verbale dhe zyrtare nga punonjësit e kësaj njësie ka qenë vazhdimisht: "Sapo të hapen aplikimet për banesa sociale, mund të aplikoni"".

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit që i bëhet për shkak të aftësisë të kufizuar fizike përmes pamundësimit të aksesit real në strehim dhe detyrimin e Bashkinë Tiranë të marri masa konkrete për regjistrimin e tij në listën e përparësisë dhe sigurimin e një banese sociale që plotëson standardet e aksesueshmërisë.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, të ndryshuar, përcaktohet se: *"Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: "'*Diskriminim' është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi".*

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Ankuesi S. C., fillimisht i është drejtuar Komisionerit me nr. 223, datë 08.09.2026, duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të "aftësisë së kufizuar", nga ana e Bashkisë Tiranë, pasi nuk përfiton nga programi i strehimit "Banesë sociale me qira". Në këtë ankesë, S. C. ka pretenduar se është interesuar dhe ka kërkuar që të aplikojë për programin "Banesë sociale me qira" pranë punonjësve të Njësisë Administrative. Po sipas ankuesit, punonjësit e Njësisë Administrative verbalisht i janë përgjigjur se në mungesë të banesave sociale, ju ofrojmë bonusin e qirasë, përgjigje të cilën ankuesi e konsideron diskriminuese, bazuar në shkakun e pretenduar.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me vendimin nr. 255, datë 22.09.2026, vendosi mospranimin e ankesës, pasi evidentoi se, pretendimi i ankuesit se kërkesa e tij ka qenë verbale, sikundër edhe refuzimi nga ana e institucionit, është i pamjaftueshëm për të provuar se ankuesi ka aplikuar pranë këtij institucioni.

Në kushtet kur, nuk provohet se ankuesi ka aplikuar për programin e strehimit "Banesë sociale me qira" pranë Bashkisë Tiranë, Komisioneri vlerësoi se nuk kishte informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim të mëtejshëm lidhur me pretendimin e ankuesit se kërkesa e tij është refuzuar nga ana e institucionit për shkaqe diskriminuese.

Nga analizimi i ankesës nr. 263, datë 13.10.2026, të depozituar rishtas nga ankuesi, ai nuk ka paraqitur përpara Komisionerit të dhëna të reja që lidhen me faktin nëse ai ka aplikuar për programin "Banesë sociale me qira". Gjithashtu, nga informacioni i administruar gjatë shqyrtimit të një ankese të mëparshme, me nr. 44, datë 24.02.2025, është administruar informacioni se nga viti 2024 e në vijim, është bërë publike hapja e thirrjes, për të përfituar nga programet e strehimit social, sipas ligjit 22/2018 *"Për strehimin social",* aplikim i cili bëhej përmes portalit qeveritar e-albania. Një njoftim i tillë rezulton të jetë bërë publik edhe në media[2].

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa "c" dhe "ç" të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, ku parashikohet se: *"4. Ankesa nuk pranohet nëse: ..... c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) ..... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;.....",* Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, si dhe për të njëjtën çështje në kuadër të një ankese tjetër, është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja, e për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj[3].

[2] https://shqiptarja.com/lajm/hapen-aplikimet-per-strehim-social-kush-perfiton-dhe-dokumentet-qe-duhen-per-te-aplikuar
https://rtsh.al/bashkia-tirane-hap-aplikimet-per-riparimin-e-banesave-per-familjet-ne-nevoje/
https://www.panorama.com.al/bashkia-tirane-hap-aplikimet-per-banesat-sociale-me-qira-ja-afati-dhe-ku-duhet-te-paraqesin-kerkesen-individet-e-familjet-ne-nevoje/

[3] Për analogji citojmë vendimet: nr. 114, datë 10.06.2022; nr. 235, datë 29.12.2022 dhe nr. 255, datë 22.09.2026 të KMD-së.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, pika 4, germa "c" dhe "ç", të ligjit 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës të paraqitur nga S. C., për arsye se nuk përmbushen kushtet ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji 10221/2010 *"Për Mbrojtjen nga Diskriminimi",* i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)